VENDIM
Nr.6, datë 16.1.2012

PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS PËR NDËRTIMIN, INSTALIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E CENTRALIT ELEKTRIK, SI DHE PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE ME SERI NPM06K, NR.41, LËSHUAR ME VENDIM TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR.83, DATË 27.11.2006 PËR SHOQËRINË ENERGO–SAS SHPK

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, pikat 2.3 dhe 2.4 e "Licencës për prodhimin e energjisë elektrike", si dhe neneve 13, 14, 15 pikat 1 dhe 2 germa "b", dhe pikat 3 dhe 4, të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008 Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.1.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë "Energo-SAS" sh.p.k. për ndryshimin e licencës nr.41, seria NPM06K, për ndërtimin, instalimin dhe shfrytëzimin e centralit elektrik, si dhe prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.83, datë 27.11.2006 dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Energo-SAS" sh.p.k., plotëson kërkesat e rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Neni 15, pika 4, germa "a": Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës.
- Neni 15, pika 4, germa "b": Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë modifikimin e licencës me nr.41, seria NPM06K, të shoqërisë "Energo-SAS" sh.p.k. "Për ndërtimin, instalimin dhe shfrytëzimin e centralit elektrik, si dhe prodhimit të energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.83, datë 27.11.2006.
2. Fuqia e instaluar e Hec-it "Sasaj" nga 7 MW bëhet 8.6 MW.
3. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani